



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.03.2021, ora 12:00

#### Drejton mbledhjen:

**Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 2 dhe 4 mars 2021
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit 22 mars – 9 prill 2021
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, Ilogari bashkëpunimi””.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Aleancës GAVI për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY) miratuar me ligjin nr. 134/2020”.

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Ralf Gjoni, Halit Valteri, Vasil Sterjovski, Reme Lala, Ligorag Karamelo, Andrea Marto, Zef Shtjefni, Ediola Braha dhe Fatmir Velaj.

#### **Mungojnë:**

Rudina Hajdari, Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Vasilika Hysi.

#### **Të ftuar:**

Ermira Gjeçi- Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Mësonjësi- Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit

Rregullator

Elisa Teneqexhi- Drejtore e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Evis Shehu - Drejtorja e Menaxhimit të Investimeve Publike

Alma Baze – Drejtore e Politikave të Turizmit

Elton Ollozi - Specialist

Mira Rakacolli- Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** - Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 18.03.2021. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 2 dhe 4 mars 2021; miratimin e kalendarit të punës së komisionit 22 mars – 9 prill 2021; projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH - Shqipëri, Ilogari bashkëpunimi””. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Gjermani. Gjithashtu, në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Aleancës GAVI për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY), miratuar me ligjin nr. 134/2020”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Gjebrea.

Të ftuar në komision kemi: zëvendësministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zonjën Gjeçi, mirë se vjen, zonja zëvendësministre; zotin Mësonjësi, zonjën Teneqexhi, zonjën Dhëmbi, zonjën Shehu, zonjën Baze, zonjën Ollozi, profesoreshë Rakacollin, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mirë se vjen profesoreshë; dhe zonjën Prodani, sekretare e Përgjithshme, mirë se vjen!

Pa humbur kohë fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 2 dhe 4 mars 2021. Nëse nuk ka kundërshti, i konsiderojmë të miratuar.

Faleminderit, kolegë!

Miratimin e kalendarit të punës së komisionit 22 mars – 9 prill 2021. Nëse nuk ka ndonjë propozim, e konsiderojmë të miratuar.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit të parë.

Fjalën e ka zëvendësministrja Gjeçi. Pastaj fjalën e ka zonja Gjermani.

Fjala për ju, zonja zëvendësministre.

**Ermira Gjeçi**- Mirëdita të gjithëve!

E nderuar kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ky projektligj, i iniciuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ka për qëllim ndryshimin e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi.

Ky instrument ka filluar zbatimin e tij në vitin 2016, si një iniciativë e qeverisë shqiptare në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e konkluduar me nënshkrimin e një marrëveshjeje më 11 janar të vitit 2016, ratifikuar me ligjin nr. 4/2016 midis Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financave dhe BERZH-it, me qëllim mbështetjen e sektorit të agrobiznesit.

Qeveria shqiptare vendos në dispozicion të BERZH-it një shumë totale prej 36 milionë eurosh, me qëllim mbulimin e riskut të humbjes së kredive deri në nivelin 20%.

Aktualisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur në dispozicion të BERZH-it, që nga viti 2016, një shumë prej rreth pesëmbëdhjetë milionë eurosh. Nën këtë instrument, BERZH-i ka partneritet me 5 institucione financiare pjesëmarrëse, banka tregtare dhe institucione mikrofinanciare jobankare, që operojnë në Shqipëri, siç janë: Fondi Besa, Procredit Bank, OTP Bank, Intesa Sanpaolo dhe Raiffeisen Bank.

Nga fillimi i programit institucionet financiare partnere kanë disbursuar rreth 6098 kredi, me një volum rreth 65,2 milionë, të cilat injektojnë direkt në sektorin e bujqësisë. Sektorët kryesorë të volumeve të disbursuara janë agropërpunimi dhe bujqësia primare, respektivisht me 28,4% dhe 27% të portofolit. Rajonet kryesore, të cilat kanë përfituar nga kjo mbështetje, janë: Tirana me 18,7%, Fieri me 17%, Korça me 16,7% dhe Lezha me 11%.

Në kuadër të bashkëpunimit të skemave të programit IPARD, mund të themi se deri në fund të vitit 2020 20% e kontratave fituese janë mbështetur nga ky fond nga bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera mikrofinanciare.

Gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së pandemisë, bankat partnere të këtij instrumenti kanë vijuar mbështetjen me financim të sektorit të bujqësisë, duke disbursuar rreth 18 milionë euro kredi të reja për fermerët dhe agrobizneset, kryesisht në dy sektorët që përmenda edhe më lart, që janë agropërpunimi dhe bujqësia primare. Gjatë këtij viti, i cili ka qenë i vështirë, bankat e nivelit të dytë kanë ofruar lehtësira në pagesat e kësteve për klientët, të cilët janë prekur nga efektet e COVID-19, me qëllim rimëkëmbjen e aktivitetit dhe

përballimin e situatës së krijuar. Gjithashtu, janë mbështetur edhe klientët përfitues të skemave të IPARD-it për realizimin me sukses të planit të tyre të investimit.

Objekti i kësaj marrëveshjeje ndryshuese është përmirësimi i aksesit për financim në fushën e bujqësisë dhe turizmit nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve jobankare mikrofinanciare.

Marrëveshja ndryshuese përfshin disa elemente të reja të dakordësuara nëpërmjet negociatave midis qeverisë shqiptare dhe BERZH-it, duke zgjeruar fushën e veprimit me qëllim rritjen e aksesit në financë.

Pika e parë ka bërë me përfshirjen e sektorit të turizmit si përfitues i këtij instrumenti për një nivel kreditimi deri në masën 30 milionë euro, në kushtet kur ky sektor ka qenë i prekur nga pandemia COVID dhe duke e konsideruar një sektorë të rëndësishëm, i cili kontribuon në ekonominë e vendit, përfshirjen e stimujve financiarë për të dy sektorët, agrobiznesin dhe turizmin, në nivelin 10% të vlerës së kredisë, me qëllim rritjen e atraksionit të përfituesve për të pasur akses për financim në këtë instrument. Pra, bëhet fjalë për huat për investime kapitale me një maturim minimumi 18 muaj dhe mbulim në nivelin e riskut deri në masën 20% për të dy sektorët. Qëndron asistenca teknike, e cila ka qenë pjesë e marrëveshjes së parë. Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet lehtësimi i aksesit në financa të agrobizneseve shqiptare apo bizneseve në fushën e turizmit për të rritur kontributin në zhvillimin e mëtejshëm të dy sektorëve, të cilët konsiderohen si prioritet strategjike për zhvillimin e vendit. Përmes mbështetjes së sipërmarrësve vendas me mekanizimin e ndarjes së riskut apo linjave të kreditimit dhe stimujve financiarë në formë granti për investime ky program jo vetëm do të jetë atraktiv përmes mbështetjes që ofron, duke nxitur dhe duke përmirësuar investimet, por paralelisht ofron një mbështetje domethënëse për aplikantët që duan të aplikojnë në skemat e programit të IPARD-it.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Kolegia Gjermani, fjala për ju.

**Eglantina Gjermani** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre, për prezantimin shterues!

Unë dua të theksoj 2-3 gjëra të rëndësishme që lidhen me këtë projektligj, i cili ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,

dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH–Shqipëri”. Në fakt, synon të përmirësojë aksesin për financim në fushën e bujqësisë dhe turizmit nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve jobankare. Unë e konsideroj shumë të rëndësishme, sidomos për faktin se bujqësia dhe turizmi janë dy nga sektorët shumë të rëndësishëm në Shqipëri dhe janë dy nga sektorët që janë goditur nga pandemia. Kështu që mendoj se kjo do të japë një impakt pozitiv në këto fusha. Me anë të kësaj marrëveshjeje ndryshuese vijohet me ndihmën që ofrohet nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me BERZH-in, me qëllim kanalizimin e fondeve drejt financimit të sektorit bujqësor, duke përfshirë edhe sektorin e turizmit.

Marrëveshja konkretisht parashikon lehtësimin e agrobizneseve shqiptare apo bizneseve në fushën e turizmit për zhvillimin e mëtejshëm të dy sektorëve, të cilët konsiderohen si prioritete strategjike jo vetëm si sektorë, por edhe për hapjen e vendeve të punës edhe për të ardhurat që sigurojmë me to.

Ky program vazhdon të mbështesë sipërmarrësit vendas nëpërmjet marrjes së riskut, linjave të kreditimit dhe prezanton një stimul të ri për investimet, sidomos për agrobiznesin, duke mundësuar një grand në vlerën 10% të kredisë për ato agrobiznese, që marrin hua për investimet kapitale me një maturim të paktën prej 18 vitesh. Ky komponent e bën programin më atraktiv, duke nxitur dhe përmirësuar investimet në vend përmes mbështetjes që ofrohet.

Ndryshimet që pëson marrëveshja ekzistuese lidhen vetëm përfshirjen e sektorit të turizmit me linjat e kreditimit dhe skemën e mbulimit të riskut për kreditë e dhëna nga institucionet financiare për përfshirjen e stimujve për investime për agrobiznesin në masën 10%.

Unë sërish do t’i falënderoja përfaqësuesit e ministrive dhe do të kërkoja vëmendjen e tyre që, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, të kenë në prioritet gratë dhe vajzat, sidomos në fushën e sipërmarrjes, të turizmit, të agroturizmit që të kenë një mbështetje më të madhe, sepse ato janë më të goditurat.

I ftoj të gjithë kolegët që ta miratojnë këtë marrëveshje dhe i uroj suksese.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Fjala për nënkryetarin Gjoni.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit, kryetare!

A dëgjohem?

**Mimi Kodheli** – Po, dëgjoheni.

**Ralf Gjoni** – Kam një pyetje për zëvendësministren Gjeci. Bujqësia, agropërpunimi dhe turizmi janë dy nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë sonë, por duke pasur parasysh skemat e mbështetjes të fqinjët tanë, për shembull Maqedonia e Veriut, ka dy mënyra: ose rritet aksesimi për kreditim, apo për huamarrje ndaj institucioneve ndërkombëtare, si BERZH-i, ose jepen subvencione nga qeveria. Ndoshta unë jam i gabuar në analizën time, por shoh që po marrim hua vazhdimisht si vend, ndërkohë që subvencionet më duken shumë të ulëta për sektorin e bujqësisë, turizmit dhe sidomos të agropërpunimit dhe agroturizmit. Pse preferoni të vazhdoni të thëlloni më tej huamarrjen, ndërkohë që duhen rritur edhe subvencionet ndaj këtyre sektorëve? Sa është niveli i subvencionimit të agropërpunimit dhe agroturizmit në këto momente *vis a vis* huamarrjes që po aplikohet në këtë sektor?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – A ka pyetje të tjera?

Nëse nuk ka pyetje të tjera fjala për zëvendësministren.

**Ermira Gjeci** – Faleminderit!

Atëherë le t'i ndajmë të dyja gjërat nga njëra-tjetra. Në dispozicion të sektorit të bujqësisë janë dy skema: skema e parë është skema kombëtare, e cila ka targetuar të gjithë nënsektorët që përfitojnë nga ndihma financiare, që jep buxheti i shtetit dhe skema e dytë janë fondet e IPARD-it. Ne po punojmë shumë fort në vitin 2021, që të hapim IPARD 3-n në 2022-n, i cili ka një rritje të shumës që bën një risi për Shqipërinë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, pasi nga shuma totale të gjitha vendet e rajonit kanë pësuar rënie në shumën e vënë në dispozicion nga Komisioni Europian, ndërkohë që Shqipëria shkon me rritje diku te 120 milionë euro. Kini parasysh që qeveria shqiptare merr pjesë bashkë me BE-në në shumën totale që vihet në dispozicion të sektorit. Në IPARD 2 ka qenë 25% e shumës totale, 90 e ca milionë euro, e vënë në dispozicion nga qeveria shqiptare.

Këto janë për sa u përket skemave kombëtare në mbështetje të sektorit të bujqësisë dhe nënsektorit përkatës të agropërpunimit. Për sa i përket aksesit në financim, se në të gjitha rastet flas për skemat e IPARD-it, të gjitha aplikantët nuk marrin 100% të shumës së investimit, që ata duan të bëjnë, por marrin nga 50 deri në 70% dhe lind nevoja për mbulimin e pjesës tjetër, në mënyrë që të realizohet investimi në masën 100%. Prandaj është lidhur kjo marrëveshje me BERZH-in, në mënyrë që ata të drejtohen në bankat e nivelit të dytë, apo në institucionet mikrofinanciare, në mënyrë që të marrin diferencën për të realizuar investimin në masën 100%. Në këtë rast hyn qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financave, bashkë me BERZH-in, për të suportuar bankat e nivelit të dytë dhe zërat janë të përcaktuar. Në këtë rast bëhet fjalë për mbulimin e riskut në masën 20% të

kredive që do të rezultojnë jo të mira, ose kreditë e këqija, siç i themi, ashtu sikurse është 10% masa e grantit. Pra, të gjithë ata që do të drejtohen për kredi në bankat e nivelit të dytë me fokus, qëllim dhe destinacion agropërpunimin, do të kenë në masën 10% një grant në bankat e nivelit të dytë, të shumës totale të tyre.

Besoje se isha e qartë me përgjigjen. Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje tjetër.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zëvendësministre!

Kush ka pyetje të tjera?

Nëse nuk ka pyetje apo komente, mendojmë ta hedhim në votim në parim projektligjin.

Do t'u lutesha kolegëve Bushati dhe Sterjovski, meqenëse jemi në proces votimi, pavarësisht se i shikoj që janë në linjë, të shfaqen edhe me video.

Kush është dakord me projektligjin? Shikoj që jemi dakord. Nënkryetari Gjoni abstenon?

**Ralf Gjoni** - Abstenim.

**Mimi Kodheli** – Dakord. 1 abstenim. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Faleminderit kolegut Bushati që hyri në linjë!

Faleminderit, Vasil!

Faleminderit, Ligoraq!

Miratohet me një votë abstenim.

Neni 2.

Miratohet me një votë abstenim.

Votojmë ligjin në tërësi, ju lutem!

Faleminderit!

Miratohet me një abstenim.

Faleminderit, zëvendësministre Gjeci!





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.3.2021, ora 12:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY), miratuar me ligjin nr. 134/2020”.

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Ralf Gjoni, Halit Valteri, Vasil Sterjovski, Reme Lala, Ligoraq Karamelo, Andrea Marto, Zef Shtjefni, Ediola Braha dhe Fatmir Velaj.

#### **Mungojnë:**

Rudina Hajdari, Alket Hyseni, Ditmir Bushati dhe Vasilika Hysi.

#### **Të ftuar:**

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodan – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Mimi Kodheli** – Kalojmë në projektligjin e dytë.

Profesoreshë Rakacolli, fjala për ju.

**Mira Rakacolli** – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Tashmë prej më shumë se një viti Shqipëria po përballet me pandeminë më të madhe dhe më të rëndë të shekullit, me COVID-19. Kanë humbur jetën mbi 2 milionë e gjysmë njerëz në mbarë botën dhe rreth 2000 qytetarë në Shqipëri. Tashmë është e qartë se e vetmja mënyrë e përmblyljes së pandemisë është imunizimi nëpërmjet vaksinimit mbarëbotëror. Asnjëherë nuk ka qenë kaq intensiv në mbarë botën kërkimi shkencor dhe prodhimi i vaksinave, dhe falë njohurive dhe teknologjisë është arritur në kohë rekord prodhimi i mbi 200 vaksinave, që janë në prova klinike, dhe deri më sot rreth 8 prej tyre kanë marrë certifikimet e përdorimit emergjent në EMA, FDA apo në agjencitë rregullatore të vendeve në të cilat ato janë prodhuar, duke u përdorur tashmë gjerësisht në mbarë botën. Vende që kanë ecur para me këtë vaksinim, siç janë, për shembull, Izraeli dhe Anglia, kanë filluar të shohin dritën jeshile, që duket në uljen e rasteve dhe në lirim të masave, por natyrisht që sasia e tyre nuk mund të jetë në të njëjtën kohë e përputhshme me kërkesën që ka. Për këtë arsye, sigurimi i vaksinave për qytetarët është sfidë e mbarë qeverive të çdo vendi.

Falë angazhimit të hershëm të qeverisë shqiptare dhe personalisht të Kryeministrit Rama, Shqipëria e ka filluar vaksinimin më 11 janar të këtij viti, vetëm 5 ditë pas Holandës, duke qenë para shumë vendeve të rajonit dhe ne të gjithë jemi dëshmitarë të ecurisë së suksesshme të këtij procesi falë dhe marrëveshjeve të hershme, që në fillim, me COVAX-in dhe Pfizer-in.

Kemi krijuar, gjithashtu, logjistikën e duhur për realizimin e këtij procesi, duke filluar me infrastrukturën, me sigurimin e zinxhirit ftohës dhe trajnimin e vaksinatorëve, për të ecur sa më shpejt dhe sa më saktë në këtë proces të rëndësishëm.

Kështu, kapacitetet aktuale për ruajtjen e vaksinës Pfizer janë 250 mijë doza njëherësh, për Moderna-n 950 mijë doza njëkohësisht, ndërsa për AstraZeneca-n, për vaksinat tjera që kanë kushte ruajtjeje si ato të zakonshmet, ne jemi në gjendje të ruajmë 7 milionë doza në të njëjtën kohë. Deri tani janë vaksinuar 33 mijë e 369 qytetarë dhe të siguruara nga kontratat e sipërpërmendura janë 1,6 milionë doza, pra për rreth 800 mijë qytetarë shqiptarë. Natyrisht që numri i atyre që janë vaksinuar është akoma i vogël, në krahasim me atë që do të duhet të jetë dhe për këtë arsye ka shumë rëndësi të ecet edhe më shpejt me procesin e ardhjes në vend të vaksinave për vetë faktin se të gjitha gjërat, të cilat janë të lidhura vetë me shtetin

tonë, pra, siç e përmenda, vaksinatorët apo krijimi i infrastrukturës së zinxhirit ftohës, janë tashmë në dispozicion.

Prandaj, që të vijë sa më shpejt, për të ecur sa më shpejt procesi i ardhjes në vend i vaksinave, të cilat janë tashmë të përfshira në portofolin COVAX, nga aleanca GAVI kërkohet një ndryshim në marrëveshjen e nënshkruar më parë që ka të bëjë pikërisht me statusin e vaksinës së livruar.

Për shkak të kohës së shkurtër të prodhimit të vaksinave, shumica e tyre janë në kushtet e autorizimit të emergjencës së përdorimit dhe jo në atë standard.

Për këtë arsye, në marrëveshjen e mëparshme bëhej fjalë që, nëse vakcina do të ishte në kushtet e marrëveshjes së autorizimit të emergjencës, duhej që vendit që do ta merrte, t'i propozohej, nëse do ta merrte ose jo, dhe vetëm pasi të merrje aprovimin nga vendi të vazhdonte livrimi sipas kushteve të tjera të kontratës. Natyrisht, kjo bën që të ketë një vonesë në marrjen dhe në livrimin e këtyre vaksinave dhe pikërisht për këtë arsye GAVI ka kërkuar që në nenin, ku thuhet se cila do të quhet vaksinë e miratuar, krahas faktit që kjo vaksinë të ketë autorizimin standard, të bëhet fjalë edhe për pasjen e autorizimit të emergjencës, gjë e cila nuk e penalizon shtetin, të cilit i propozohet kjo vaksinë, në qoftë se ai do që të mos e pranojë këtë vaksinë. Pra, futja e këtij koncepti bën që të mos humbasim kohë dhe vakcina e propozuar të vijë sa më shpejt.

Nëse bëhet ky miratim i ndryshimit të përkufizimit të vaksinës së miratuar, atëherë bien edhe dy pika të tjera të kontratës që kanë vendet me GAVI-n, pikërisht pikat 11 dhe 16 për mënyrën e prokurimit se cila do të quhet vaksinë e miratuar.

Ne vlerësojmë se është një amendim, i cili nuk bën gjë tjetër veç faktit që fiton kohë në marrjen dhe në përdorimin e vaksinës dhe është një marrëveshje që duhet ratifikuar.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Fjalën e ka kolegja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja Zëvendësministre,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, zëvendësministrja, zonja Rakacolli, e shpjegoi shumë qartë qëllimin e këtij projektligji, nevojën, të gjithë kontekstin ku qëndron Shqipëria për sa i përket vaksinimit, nevojës për t'u vaksinuar, por pa dyshim edhe nevojës për të reaguar në rastet kur kërkohet një përsheptim i procedurave apo i marrëveshjeve ekzistuese.

Në këtë kontekst, qëllimi i këtij projektligji është miratimi i ndryshimeve të marrëveshjes ekzistuese të angazhimit nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në këtë rast nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe aleancës GAVI për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19, e cila, në fakt, është miratuar në ligjin nr. 134/2020.

Pra, sikurse u tha edhe nga zëvendësministrja, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka pasur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e aleancës GAVI.

Dëshiroj, në fakt, ta falënderoj për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë ministria dhe të gjithë përfaqësuesit në situatën e pandemisë që ka prekur, përveç Shqipërisë, të gjithë globin.

Në këtë marrëveshje kërkohet që të ketë një ndryshim për sa i përket statusit të autorizimeve të përdorimit emergjent, i cili lejon të përshpejtohet caktimi i vaksinave që kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent, në mënyrë që të mos vonohet edhe alokimi i tyre.

Unë dëshiroj ta theksoj se çfarë do të thotë “vaksinë e miratuar”. Pra, vakcina e miratuar nënkupton një vaksinë kundër COVID-19 në lidhje me të cilën GAVI ka ndërmarrë një angazhim të përparuar të blerjes që ka parakualifikim të OBSH-së, autorizim standard të kushtëzuar marketingu ose një autorizim për përdorim emergjent të vendosur nga SRA-ja apo autorizim përdorimi emergjent nga OBSH-ja.

Unë ju ftoj, të nderuar kolegë, ta miratojmë këtë dhe të bëjmë të mundur kështu, që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të përshpejtojë punën e vet, për të pasur sa më shumë akses në vakcina dhe sa më shumë vakcina ofruar për qytetarët shqiptarë.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegja Gjebrea!

Po, nënkryetar Gjoni.

**Ralf Gjoni** - Faleminderit, kryetare!

Unë deklaroj votën time absolutisht kundër këtij ndryshimi të kësaj marrëveshjeje, siç e kam deklaruar edhe në debatin e madh që ne bëmë në seancë plenare me ministren Manastirliu, të cilën e kam edhe mikeshë të vjetër, por për të cilën kam edhe shumë respekt, por kjo s’ka të bëjë fare me vendimmarrjen në kuadër të vaksinimit të popullsisë.

Së pari, dy opinione personale dhe, ju lutem të nderuar kolegë, mos i merrni aspak si qëndrime pulitke, se unë nuk jam as në fushatë elektorale, as nuk kandidoj dhe nuk kam asnjë interes të bëj politikë në këtë moment, thjesht dua të flas nga ana teknike. Është e qartë që shumë vende, edhe më të zhvilluara se ne, kanë dështuar në përjasjen e blerjes së vaksinave dhe sigurimit të dozave. Mjafton të përmendim Francën, Gjermaninë dhe

Bashkimin European dhe lojërat e fundit politike që po bëhen me AstraZeneca dhe me Britaninë e Madhe, për të kuptuar se çfarë fiasko ka qenë planifikimi i sigurimit të dozave të mjaftueshme për vaksinimin e popullsisë të vendeve anëtare të BE-së. Mendoj që edhe qeveria shqiptare e filloi shumë-shumë vonë negociimin me kompanitë private. Unë këtë çështje e kam ngritur edhe në Parlament, nuk më është dhënë përgjigje e qartë dhe nuk është bërë aspak transparencë për sa u përket tratativave të qeverisë shqiptare për të siguruar doza vaksinash në tremujorin e katërt të vitit 2020.

Zëvendësministrja Rakacolli përmendi që ka rreth 33 mijë qytetarë të vaksinuar. Më lejoni të ngre një pikëpyetje për këtë. Unë nuk e di se ku janë këta qytetarët të vaksinuar dhe dua t'ju kërkoj zyrtarisht të na jepnit një pasqyrë të qartë, transparente dhe për këtë unë do të angazhohem edhe për dërgimin e shkresave zyrtare drejt ministrisë, për të marrë transparencë të plotë. Ku janë këta 33 mijë qytetarë? Nga kanë ardhur këto vakcina? Doni të thoni që ne paskemi siguruar 33 mijë vakcina Pfizer dhe AstraZeneca deri në këtë moment?

Dua ta di me zëra të specifikuar se nga janë siguruar këto vakcina. Dëgjoj informacione jozyrtare dhe unë këtë do e konfirmoj, dhe do t'i shkoj deri në fund bashkë edhe me kolegë të tjerë të opozitës, që ka një treg të zi, i cili po eksplorohet aktualisht. Nuk po e lidh fare me ju, si Ministri e Shëndetësisë, por ekziston një treg i zi dhe ka një numër goxha të madh, jo të vogël vaksinash të vendeve lindore, s'po i përmend me emra specifike, që po vijnë në Shqipëri përmes një aleati që gjeografikisht ndodhet në lindje të vendit tonë. Kjo po më bën shumë përshtypje, sepse bëhet fjalë për mungesë totale transparence dhe përgjegjshmërie, për sa i përket vaksinimit të popullsisë shqiptare.

Së dyti, COVAX-i, zonja Rakacolli, pavarësisht se intensionin e ka pozitiv, për të ndihmuar vendet e varfra dhe vendet e botës së tretë, COVAX-i ka vënë në dispozicion të Shqipërisë, mesa kuptoj unë, rreth 141 mijë vakcina, të paktën kështu thuhet në faqen zyrtare të aleancës GAV dhe të COVAX-it. I bie, me një përlllogaritje që unë bëra që, nëse marrim dozën e AstraZeneca-s, që është siguruar nga vendet e tjera me një kosto për dozë diku te 2 deri në 3 euro, i bie që ne, në qoftë se marrim në total nga COVAX-i 141 mijë vakcina, me aq para sa ne i paskemi dhënë kësaj aleance, i bie që doza shkon diku te 24 dollarë, 24 euro për dozë, që për mua është një shpërdorim flagrant i fondeve publike të Shqipërisë, me një vendim strategjikisht shumë të gabuar, për t'i çuar këto para drejt COVAX-it, ndërkohë që ne mund të kishim negociuar si Izraeli apo edhe vende të tjera, direkt me kompani private apo me vende të tjera, për të siguruar doza direkt nga prodhuesit dhe jo përmes një aleance që merret me botën e tretë.

Për sa i përket vaksinimit, zonja Rakacolli, unë nuk e shoh se ku jemi ne pas Holandës, nuk e shoh, sinqerisht. Kemi shumë pensionistë, mamaja ime është aktualisht e infektuar me COVID. Po të ishte vaksinuar, ndoshta nuk do të ishte infektuar. Lavdi Zotit që, deri tani nuk ka vonesë, por njoh shumë njerëz të moshuar, të cilët kanë pasur probleme dhe shpenzime financiare marramendëse për të përballuar sëmundjen e Covidit. Këta nuk janë vaksinuar.

Kemi humbur rreth 35 mjekë dhe ju e dini më mirë se unë, zonja Rakacolli. Nuk e kemi luksin të humbasim 35 mjekë. Nëse këta mjekë do të ishin vaksinuar përpara mësuesve, ndoshta do të ishin në jetë sot. Përmend vetëm rastin e fundit të mjekut të nderuar Geron Husi, për të cilin janë ngritur pretendime nga familjarët, por edhe nga kolegët në QSUT, që, nëse do të kishte pasur akses ndaj vaksinimit nga mjekët e QSUT-së, sot ai do të ishte gjallë.

Ku janë këta 33 mijë veta që janë vaksinuar? Nga kanë ardhur këto doza? Pse shpenzojmë lekë kot drejt aleancave si COVAX-i, ndërkohë që ju i sillni këto marrëveshje dhe ndryshime marrëveshjesh në Kuvend? Çfarë pune keni me Kuvendin, nuk e kuptoj! Bëjeni vetë si qeveri. Lidhni marrëveshjen. Sa koncesione dhe akte normative firmos qeveria shqiptare me qindra dhe miliona euro në vit dhe nuk i sjell detyrimisht në Kuvend? Pse na e ngarkoni neve përgjegjësinë për t'i dhënë legjitimitet paaftësisë së ekzekutivit. Nuk e kuptoj pse jepni lekë te COVAKX-i, ndërkohë që ju duhet të kishit siguruar doza nga prodhuesit drejtpërdrejtë? Unë e deklaroj votën time kundër, kryetare.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, nënkryetar!

Ka pyetje të tjera?

Megenëse nuk ka pyetje të tjera, përpara se t'ia jap fjalën zëvendësministres, më lejoni të bëj një koment si anëtare e këtij komisioni lidhur me çështjet që parashtroi kolegu Gjoni. Në qoftë se nuk e dëgjova gabim zëvendësministren, nuk tha që ...

**Ralf Gjoni** – Më fal, kryetare, por nuk e shikoj të udhës. Ka mundësi të më përgjigjet njëherë zëvendësministrja dhe pastaj të kemi komente?

**Mimi Kodheli** – Jo, unë po bëj komentet e mia. Zonja Rakacolli ka të drejtën të flasë pasi unë si anëtare e komisionit të bëj komentet dhe pyetjet që kam për të bërë. Jam kryetare, por jam edhe anëtare.

**Ralf Gjoni** – Komente mbi komente nuk e shikoj të udhës, zonja Kodheli.

**Mimi Kodheli** – Dua t'ju sqaroj për çka zëvendësministrja tha, jo ju.

**Ralf Gjoni** – Dakord, por unë nuk kërkoj sqarime nga ju, por nga ekzekutivi.

**Mimi Kodheli** – Patjetër. Ekzekutivi ka mbajtur shënimet e radhës. Unë kam të drejtën, si çdo anëtar i këtij komisioni, të bëj komentet e mia mbi çfarë tha zëvendësministrja.

Zëvendësministrja tha që ne kemi filluar vaksinimin pesë ditë pas Holandës. Pra, nuk bëri asnjë krahasim, veçse dha një fakt. Meqë jemi te Holanda, ne me Holandën nuk mund të krahasohemi, por në këtë rastin e pandemisë krahasohemi që çke me të, sepse sot që flasim e dhëna e tanishme është që ka 942 të vdekur për 1 milion banorë, në një kohë që Shqipëri ka 728. Pra, vetëm kjo e dhënë na bën të jemi pak më mirë në menaxhimin e kësaj situate të jashtëzakonshme, meqë po flisnim për Holandën dhe meqë zëvendësministrja, profesoresha, e mori si shembull.

Unë besoj që momentet janë dy. Unë kam parë, për aq kohë sa i ndjek në mënyrë didaktike dhe intensive mediet, por edhe lajmet në Shqipëri, që Kryeministri Rama ka qenë ndër të parët drejtues qeverish që në këtë botë ka marrë avionin dhe ka shkuar të takojë konkretisht përfaqësuesit dhe pronarët e Pfizer BioNTech. Thjesht dhe vetëm dua ta rikthej në vëmendjen e qytetarëve këtë detaj. Pra, nuk ka qenë një ndër të fundit apo indiferentët, por ka qenë një ndër të parët që fizikisht ka shkuar vetë.

Për sa i përket projektit të përbashkët europian apo fondit garanci, këto nuk janë para të hedhura në tym, sepse paratë shpenzohen kur të vijë vaksina. Unë nuk jam këtu për të diskutuar çmimin e vaksinave, sepse është një treg që ne sado të jemi ekspertë dhe ta diskutojmë, është një treg që lëviz shpejt dhe i paqartë, meqë ka qenë i pahulumtuar më parë, por, në gjykimin tim modest, vaksina mund të jetë 24 dollarë, madje mund të jetë edhe 124 dollarë, dhe prapë nuk vlen mjaftueshëm kur flitet për shpëtimin e jetës së njerëzve. Pra, ne vaksinat duhet t'i kishim blerë me çdo çmim, pavarësisht se, me sa informacion kam, nuk gjykoj se ne kemi marrë çmimin më të lartë të vaksinës, përkundrazi.

Gjithashtu, nëpërmjet ndryshimeve që i bëjmë këtij projektligji, i japim hapësirë tregut të vaksinave. Kjo do të thotë se sot strukturat europiane, të specializuara për të treguar se cila vaksinë bën dhe cila nuk duhet të qarkullojë, kanë arritur në konkluzionin që, përtej të gjithë gjeopolitikës, është kuptuar që vaksinat që vijnë nga Perëndimi ose vaksinat që vijnë nga Lindja janë në konkurrencë dhe në gjykimin e ekspertëve janë me gjasë pothuajse të gjitha njësoj në efektshmëri. Kjo do të thotë që vaksina ka vetëm një emër, vaksina kundër COVID-it, pastaj ku është prodhuar, si është prodhuar, më çfarë çmimi del, sigurisht që ka një treg, i cili duhet të mire menaxhohet nga këndvështrimi i interesave të qeverisë shqiptare dhe të shqiptarëve.

Jam plotësisht dakord me kolegët ku thonë që, kjo është një gjë e ditur, nuk është një gjë që po e themi ne, sepse e kanë thënë të tjerët përpara, strukturat e BE-së kanë dështuar

në negociata të suksesshme lidhur me sigurimin e vaksinave për qytetarët e tyre, në një kohë që, sikur të prisnim një radhë, sipas radhës që ishte caktuar, ne nuk do ta kishim filluar ende vaksinimin e popullsisë. Pastaj, nëse sikur dikush të mos kishte bërë vaksinën, se po të kishte bërë vaksinën nuk do të ishte larguar nga jeta, ne nuk jemi këtu për të folur për emra të përveçëm, për fat të keq, janë larguar mjekë nga jeta në Shqipëri, ashtu siç janë larguar edhe në vendet më të zhvilluara të botës, sepse ata kanë qenë persona totalisht të ekspozuar në mënyrë maksimale çdo ditë ndaj virusit.

Të gjithë e kemi nga një njeri të moshuar në shtëpi dhe jemi të interesuar që t'i vijë radha të bëjë vaksinën, por do t'i ftoja të gjithë të moshuarit që të mbajnë maskë dhe të evitojnë grumbullimet e panevojshme, edhe mjediset e mbyllura deri në momentin që vaksinimi i tyre të ndodhë. Kjo gjë është e vlefshme edhe për të rinjtë, jo vetëm për të moshuarit. Kështu që, besoj se këtu ne jemi për të dhënë edhe këtë mesazh, jo për të vënë në korner ata si zonja Rakacolli ose kolegët e saj janë realisht dhe maksimalisht janë përpjekur të bëjnë më të mirën në këtë rast të jashtëzakonshëm.

Zonja Rakacolli, a keni ndonjë koment për të bërë?

**Mira Rakacolli** - Faleminderit!

Së pari, do të doja ta nisja me një urim për një shërim sa më të shpejtë të zonjës nënë, të deputetit të nderuar Gjoni!

Sa i përket informacionit që zoti Gjoni kërkon, ju bëj me dije që të 33 mijë personat e vaksinuar, të gjithë raportohen, pra raportimi bëhet publikisht se cilës kategori i përkasin.

Dua të bëj me dije që ka filluar vaksinimi me ata që janë në vijën e parë të luftës anticovid, personelin shëndetësor që punon në spitalet COVID. Tashmë është i vaksinuar i gjithë personeli shëndetësor që punon në spitalet COVID të vendit, me përjashtim të atyre, të cilët e kanë shtyrë vetë, me formularë dhe kanë firmosur për faktin se kanë quajtur të paarsyeshme për ta bërë në atë moment, i cili është propozuar, e ka lënë për një moment të dytë, sepse e kanë kaluar COVID-in.

Po ashtu, ka përfunduar vaksinimi personeli shëndetësor në mbarë vendin për strukturat publike dhe po vazhdon për ato private. Paralelisht janë vaksinuar të gjithë ata persona të moshuar, që jetojnë nëpër azile apo në shtëpitë e të moshuarve së bashku me personelin shëndetësor apo mbështetës që u shërben atyre.

Prej disa ditësh tashmë ka filluar edhe vaksinimi masiv i arsimtarëve, gjë e cila jo vetëm që është raportuar çdo ditë me shifra në raportet ditore që Ministria e Shëndetësisë bën publikisht, por njëkohësisht është ndjekur edhe nga kamerat e mjaft televizioneve publike dhe private.



Në lidhje me sasinë e dozave që kemi aktualisht në Shqipëri, ato janë rreth 80 mijë, prej të cilave 38 mijë janë AstraZeneca dhe e gjithë pjesa tjetër është Pfizer.

Në lidhje me numrin e vaksinave të siguruar nga Aleanca COVAX, dua t'ju them se në total janë 1 milion e 140 mijë doza të paguara. Pra, sasia totale e parave që janë shpenzuar për këtë gjë nuk ka të bëjë me 104 mijë dozat, sepse marrëveshja COVAX u ofrohet të gjitha vendeve që janë në këtë aleancë në përputhje me numrin e popullsisë, një përqindje e barabartë, pra që ta marrin të gjithë në të njëjtën kohë. Kjo është 140-mijëshi, që në dritaren e parë i lëvrohen 140 mijë. Pra, nuk janë 140 mijë për 3,9 milionë euro që ne kemi paguar, pra në total janë 1 milion e 140 mijë doza të paguara.

Në lidhje me faktin që thuhet pse nuk është negociuar me kompanitë më parë, të mos harrojmë një fakt, të mos harrojmë faktin se kur jemi futur në Aleancën COVAX. Ne jemi futur kur ende nuk kishte asnjë vaksinë të miratuar, pra ishin të gjitha në fazë *clinical tries*, pra nuk kishte ende asnjë vaksinë, dhe nuk dihej se cila kompani do ta prodhonte vaksinën. Kompania COVAX kishte portofolin më të madh të vaksinave, ku përfshihet edhe AstraZenica, e cila, në momentet kur është nënshkruar marrëveshja, ka qenë në fazën e tretë të *clinical tries*. Rezultoi që ishte Pfizer ai që e prodhoi i pari vaksinën dhe që iu miratua, që, fatkeqësisht, nuk ishte në portofolin COVAX.

Këtu dua të theksoj edhe një herë meritën e Kryeministrit Rama, që e përmendi shumë mirë edhe zonja Kodheli, që mori avionin dhe shkoi për të negociuar për marrjen e vaksinave të reja dhe 500 mijë vaksina të Pfizer janë pikërisht në sajë të negociatave që ka bërë personalisht Kryeministri me kompaninë Pfizer.

Të mos harrojmë që ndërkohë edhe vetë aleanca COVAX hyri në traktativa me kompanitë Pfizer, që tashmë është pjesë e portofolit të COVAX-it, nga i cili mund të përfitojë edhe Shqipëria. Po ashtu, edhe Moderna, e cila nuk ishte pjesë e portofolit të COVAX, tashmë është bërë pjesë e saj.

Vendimi për të hyrë në COVAX, dua ta theksoj, është marrë atëherë kur akoma nuk dihej se cila kompani do të dilte.

Në opinionin tonë qeveria nuk është vonuar në asnjë minutë (jo ditë apo muaj) në përpjekjet për të siguruar sa më shpejt të jetë e mundur sigurimin e vaksinave të nevojshme.

Pikërisht, për të përshpejtuar këtë gjë, është edhe ky amendim, i cili propozohet për ratifikimin e marrëveshjes, sepse nuk është një ndryshim që kërkohet nga ne, por kërkohet nga Aleanca GAVI, pikërisht për të mos lejuar procedurat burokratike, në mënyrë që të bëhet sa më shpejt i mundur lëvrimi i vaksinave jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për të gjitha

vendet pjesëmarrëse në këtë aleancë, për ta vënë sa më shpejt në dispozicion të qytetarëve që të evitojmë humbjen e jetëve të të gjithë njerëzve.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** - Zonja Prodani, keni diçka për të shtuar?

**Geraldina Prodani** – Doja të shtoja se alokimi që i ka ardhur Shqipërisë nga mekanizmi COVAX ka të bëjë me alokimin që COVAX-i ka bërë Shqipërisë për periudhën janar-maj, ku do të jenë 140 mijë doza AstraZeneca. Më pas kemi një thirrje tjetër, në të cilën jemi pjesë, ku do të kemi 380 mijë doza të Pfizer-it, të cilat do të vijnë përsëri nëpërmjet këtij mekanizmi, për periudhën qershor-gusht. Ndërkohë, jemi duke pritur edhe alokimet nga Johnson&Johnson, për të cilën jemi shprehur dakord për të qenë pjesë, si dhe të gjitha hapave dhe thirrjeve që bën mekanizmi COVAX.

Sa i takon bilancit financiar që ne kemi parapaguar ajo rakordohet kundrejt një periudhe dhe bëhen llogaritë: sa janë parapaguar, cilat kanë qenë çmimet që kanë dalë, si dhe cilat janë çmimet e unifikuara. Për këtë arsye është mekanizmi COVAX, për të mos i lejuar kompanitë që të abuzojnë me çmimet. Pfizerin e kemi marrë me 10 dollarë, AstraZeneca-n e kemi marrë me 4 dollarë, pra me çmime shumë të favorshme për të gjitha vendet, duke i vendosur në të njëjtën ekuilibër si vendet e zhvilluara ashtu edhe vendet e pazhvilluara.

Instrumenti COVAX është i përbërë nga vendet e zhvilluara, vendet në zhvillim, ndërsa vendet e treta janë shumë pak, megjithatë Shqipëria është një ndër vendet që është me vetëfinancim, pra për të pasur aksesin e parë në thirrjet që ky mekanizëm jep.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Zoti Gjoni.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Rakacolli, të falënderoj, sepse jeni e para që na ka dhënë një konfirmim të shifrave totale që ne presim nga COVAX-i!

Këtë problem e kam ngritur dhe stërngitur nëpër seancat plenare dhe nuk kam marrë asnjëherë përgjigje sa i takon numrit total të dozave.

Edhe një herë, për të sqaruar pozicionimin, jam pro vaksinimit masiv të shoqërisë sonë dhe të të gjithë fqinjëve tanë, sepse është e vetmja rrugë, me sa duket, nga mjekët dhe nga shkenca, për të dalë nga kjo pandemi, nga kjo flamë, e cila me aq sa po shoh do të zgjasë edhe këtë vit, por ndoshta edhe vitin tjetër. Kështu që të mos keqkuptohet qëndrimi, kam dashur që në fillim që të bëhej transparencë të plotë, ju besoj e mirëkuptoni shqetësimin e disa deputetëve, sepse kemi të bëjmë me një terren, do ta quaja lufte, lufte komerciale, meskiniteti dhe një hipokrizie edhe nga vende që pretendojnë se janë demokratike dhe që

ndajnë vlera bashkëkohore e të tjera. Duket qartë që këtu kemi të bëjmë me një luftë shumë të shëmtuar ndërmjet shteteve dhe kompanive, si dhe me shumë *fake news* për të përhapur panik dhe frikë për të mos u vaksinuar.

Me këtë që ju më thatë, duke falënderuar edhe kryetaren për ndërhyrjen e saj, për t'i dhënë Cezarit atë që meriton Cezari, e tërheq votën time kundër dhe votoj pro këtij projektligji.

Shumë faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjalën e ka Zef Shtjefni.

**Zef Shtjefni** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e kam dhënë mbështetjen time që para 1 viti për qendrën COVAX vetëm me një qëllim, pavarësisht se jemi deputetë të opozitës, dëshiroj që çdo qytetar shqiptar të vaksinohet. Më vjen shumë keq që përditë vdesin njerëz, ndërsa ne merremi me gjëra të vogla përpara gjërave të mëdha që kemi përpara. Dëshira ime është që të gjithë qytetarët shqiptarë të vaksinohen, si dh çdo marrëveshje që do të vij këtu do ta ketë përherë votën time.

Nëse ka probleme që ligji është shkelur, atëherë Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të merret me ata që e kanë shkelur.

Vota ime është pro këtij projektligji.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zef!

Falënderoj të gjithë kolegët për mbështetjen dhe për prezencën e tyre sot!

Këtu mbyllet diskutimet dhe kalojmë në votim.

Besoj se të gjithë kolegët janë gati për votim.

Kush është dakord me projektligjin?

Falënderoj zotërinjtë Ligoraq, Ervin, Qefalia, Vasil, Zef dhe Ralf, zonjat Reme, Eglantina dhe Elona.

Miratohet.

Neni 1? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj për prezencën, profesoreshë Rakacolli dhe zonja Prodani!

Falënderoj të gjithë kolegët për pjesëmarrjen e tyre!

Do të shihemi në mbledhjen e radhës.

Ju uroj ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**